

Projekt për të rinjë LIFT — Informacion për prindër

Të dashur prindër

Qëllimi i shkollës është që mundësisht të gjithë nxënësit me gjetë një vend profesioni (Lehrstelle).

Mbase se për disa nxënës, për shkak të ndryshme, nuk është aq lehtë me gjetë një vend profesioni, do të mbështeten nga projekti LIFT.

Nëse ju sëbashku me fëmijun tuaj vendosni me marr pjesë në projektin LIFT, këto informata janë të rëndësishme:

- Të rinjtë në kohë të lirë, punojnë përafësisht 3 orë në javë punë të thjeshta dhe praktike në një vend pune javore në një ndërmarrje (Firma)
- Të rinjtë në shkollë do të parapregaditen me module të projektit LIFT, do të ndihmohen dhe do të mbikqyren
- Ndërmarrja paguan zakonisht CHF 5.- në orë
- Puna në të njëjtën ndërmarrje zgjat sëpaku 3 muaj, qëllimi është 9 muaj në një vend pune javore
- Në fund, të rinjtë marrin nga ndërmarrja një dëftesë pune edhe një certifikat nga projekti LIFT
- Me pjesëmarrjen në projektin LIFT, nxënësit nuk humbin orë mësimi

Me punën javore, të rinjtë mësojnë aftësit por edhe kërkesat dhe rregullat në botën e punës. Me modulet forcohet personaliteti (karakteri) dhe mësojnë se çka kërkohet prej tyre në profesion dhe në botën e punës. Në të njëjtën kohë mësojnë sjelljen e tyre me të rriturit.

Për pjesëmarrjen në projektin LIFT kërkohet nga fëmija juaj disiplin dhe vullnet, në të njëjtën kohë, rriten dukshëm mundësitë për gjetjen e profesionit që preferon.

Për me pas sukses, shoqrimi dhe përkrahja e juaj si prindër është i rëndësishëm.

Ju jeni bashkëpërgjegjës që fëmija juaj:

- Merr pjesë rregullisht në kurset module
- Shkon në kohë të paracaktuar në vend pune
- Lajmrohet në kohë në rast mungese

Kështu mund ti ndihmoni fëmijës juaj:

- Motivoni fëmiun në rastë mos vullneti të jetë i disziplinar edhe i qëndrueshëm në punë
- Interesoheni çfarë punon dhe çka përjeton në punë fëmija juaj
- Interesoheni për punën edhe për ndërmarrjen ku fëmija juaj punon. Për shembull, vizitoni fëmiun në ndërmarrje (me paralajmrim)

Për me pas sukses, me rëndësi është edhe mësimi ne shkollën profesionale.

Suksesi i projektit LIFT është i varur nga puna dhe vullneti i fëmijës si dhe nga bashkëpunimi i prindërit, shkollës dhe ndërmarrjes. Na gëzonë një bashkëpunim i mirë me ju!

Nëse keni pyetje, jemi në dispozicionin e juaj.

Përshendetje të sinqerta

©Jugendprojekt LIFT